



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:038145
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825734

Pml.nr.374/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Valdete Daka anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit E. D., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, parashikuar me nenin 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.92/2024 të datës 20.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.504/2024 të datës 31.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 14.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit E. D., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.92/2024 të datës 20.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.1.nr.504/2024 të datës 31.05.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.92/2024 të datës 20.05.2024, të pandehurve E. D. dhe L. B., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, parashikuar me nenin 267, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t’iu zgjasë nga data 20.05.2024 e deri me datën 20.07.2024. Masa e paraburgimit iu është vazhduar në bazë të nenit 190, paragrafi 1 lidhur me nenin 184, paragrafi 1, nën-par. 1.1, dhe 1.2, pika 1.2.1 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.I.nr.504/2024 e datës 31.05.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit E. D., avokate Leonora Dervishaj Pacolli, për shkak të shkeljes së të drejtave që i njihen palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shkeljes së KPRK, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t’i ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit t’i caktohet masa e paraqitjes në stacion policorë ose çështja të kthehet në rivendosije.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.158/2024 të datës 14.06.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësja ka theksuar se shkeljet e kodit penal kanë të bëjnë me kualifikimin e veprës penale, ngase i pandehuri ngarkohet për një vepër të cilën nuk e ka kryer. Nuk është bërë individualizimi i veprimeve veç e veç për të pandehurit, por në mënyrë të përgjithësuar për të gjithë të bashkëpandehurit në procedurë. Nuk ka dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale, rreziku i ikjes arsyetohet me peshën e veprës penale, mirëpo KPRK nuk parashihet dënime shumë të lart për këto vepra penale. Po ashtu, edhe për rrezikun e përsëritjes së veprës penale nuk janë dhënë arsye konkrete. Sa i përket motoçikletës, dokumentet e gjetura në banesën e të pandehurit nuk janë për atë motoçikletë, por për tjetër motoçikletë tjetër. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me KEDNJ, GJEDNJ si dhe me raportin e OSBE-së, paraburgimi është masa më e rëndë dhe duhet që të kufizohet në kohë sa më të shkurtër të mundshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga aktakuza PP.I.nr.25/2024 e datës 25.04.2024 dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. e 1.2. të KPP.

Po ashtu, kjo Gjykatë, gjen se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për faktin se i pandehuri ka qenë i pa qashtëm për organet e drejtësisë, përkatësisht nuk i është përgjigjur ftesave të prokurorisë, e për çka gjykata me datë 05.02.2024, duke u bazuar në kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.25/2024 të datës 02.02.2024, ka lëshuar urdhër arrest, është e arsyeshme droja fshehjes, arratisjes apo edhe ikjes dhe në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale, ku janë gjetur 60 (gjashtëdhjetë) paketime të vogla me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 40.19 gram, dy (2) qese me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 40.62 gram, të cilat kanë qenë të vendosura në motoçikletën me ngjyrë të zezë, pronë e të pandehurit, e të cilat kanë qenë të fshehura me qëllim të shitjes, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Janë të pabazuara pretendimet e mbrojtëses së të pandehurit lidhur me kualifikimin apo cilësimin juridik të veprës penale, ngase procedura penale është në vazhdim e sipër, dhe se pritët që në fazat e ardhme, sidomos në shqyrtimin gjyqësor, të vërtetohen provat dhe faktet lidhur me elementet e veprës penale si dhe do të qartësohen edhe veprimet konkrete të të pandehurve, në këtë fazë dhe me këtë mjet juridik shqyrtohet bazueshmëria dhe ligjshmëria e bazave të paraburgimit, pasi që në këtë fazë të procedurës penale, si parakusht për paraburgimin mjafton një nivel i arsyeshëm i dyshimit të bazuar, i cili sipas të lartcekurave plotësohet dhe këto rrethana nuk e vënë në dyshim ekzistimin e arsyeve për bazat e paraburgimit.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale e as te ligjit penal, sepse të dy gjykatat kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i konsideron edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera alternative – masa e paraqitjes në stacion policor, janë të pamjaftueshme për sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437, të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:038145
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05825734

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr. 374/2024 me datën 14.06.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala